



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
KRYETARI

VENDIM

Nr 33359 datë 2.9 2021

Mbi

**VLERËSIMIN E PËRFORMANCËS NË SHËRBIMIN PUBLIK TË
TRANSPORTIT QYTETËS TË UDHËTARËVE NË LINJËN NR. 14 UNAZA PËR
PERIUDHËN KORRIK 2021 DERI 31 GUSHT 2021**

Në bazë të urdhërit të Kryetarit nr. 28424, datë 26.07.2017, për “Ngritjen e komisionit vlerësues në zbatim të urdhëresës nr. 27458, datë 13.09.2016 (me ndryshime)”, Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 për “Transportet rrugore” (i ndryshuar), Udhëzimin nr.5627, datë 18.11.2016 për përcaktimin e “Kritereve, rregullave dhe dokumentacioni për lëshimin e liçencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit” (i ndryshuar), Urdhërin nr.27309, datë 13.09.2016 për “Kushtet e përgjithshme të ofrimit të shërbimit publik të transportit qytetas të udhëtarëve në zbatim të Vendimit nr. 39, datë 23.05.2016 të Këshillit Bashkiak “Për përcaktimin e linjave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve në Bashkinë e Tiranës, mënyrën e organizimit të shërbimit dhe përcaktimin e stacioneve të qëndrimit të autobusëve të shërbimit në këto linja”” (i ndryshuar), Licenses nr. 871 “Për kryerjen e shërbimeve të rregullta qytetës të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, Kontratës së shërbimit me protokolluar nga Bashkia Tiranë me nr.prot. 871/1, datë 10.01.2017; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.39, datë 23.05.2016, për “Përcaktimin e linjave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve në Bashkinë e Tiranës, mënyrën e organizimit të shërbimit dhe përcaktimin e stacioneve të qëndrimit të autobusëve vetë shërbimit në këto linja” (i ndryshuar), Urdhëresën e Kryetarit nr. 27458, datë 13.09.2016 “MONITORIMIT, INSPEKTIMI, RAPORTIMIT DHE VLERËSIMIT TË PËRFORMANCËS NË SHËRBIMIN PUBLIK TË TRANSPORTIT QYTETËS TË UDHËTARËVE DHE ZBATIMI I MASAVE PËR SHKELJET E KONTRATËS SË SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT QYTETËS” (me ndryshime), Vendimit nr. 31182/2, datë 11.08.2021, Vendimit nr. 31559/4, datë 19.08.2021, Vendimit nr. 32177/5 datë 30.08.2021, Raportit të DTTRR- së “RAPORTI PËR PËRFORMANCËN E SHËRBIMIT TË LINJËS SË TRANSPORTIT QYTETËS NR. 14 UNAZA PËR PERIUDHËN KORRIK 2021 DERI NË 31 GUSHT 2021, me propozim nga Komisioni i Vlerësimit,

VENDOSI:

1. Vlerësimin e Performancës së linjës së transportit qytetës nr. 14 Unaza për periudhën Korrik 2021 – 31 Gusht 2021, si mëposhtë:

Për periudhën Korrik 2021 – 31 Gusht 2021 nga totali i pikëve të licencës së Linjës Nr. 14“Unaza”, Operatori: shoqëria Ferlut sha **i hiqen 300 pikë, me pasojë heqjen e licencës, prishjen e njëanëshme të kontratës dhe sekuestrimin e sigurimit të kontratës.**

2. Drejtoria e Transportit e Trafikut Rrugor (pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike) ngarkohet të bëj njoftimin e operatorit mbi këtë vendim, si dhe të ndjekjë procesin e heqjes së licencës, prishjen e njëanëshme të kontratës dhe sekuestrimin e sigurimit të kontratës.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licensimit, Drejtoria e Transportit e Trafikut Rrugor, Agjensia për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Policia Bashkiake për zbatimin e këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Erion Veliaj

